



Protokoll i Shtesë 6 i CEFTA-s mbi Tregtinë e Shërbimeve

Informacion hyrës për kompanitë



Co-funded by
the European Union

Protokoli Shtesë 6 (AP6) zgjeron veprimtarinë CEFTA-s në tregtinë e shërbimeve, përveç tregtisë së mallrave industriale dhe agro-ushqimore.

Protokoli është miratuar në mbledhjen e Komitetit të Përbashkët në Tiranë në dhjetor 2019 dhe ka hyrë në fuqi më 11 janar 2021.

ÇFARË MBULON AP6?

CEFTA mbulon Ballkanin Perëndimor dhe Moldavinë, një treg i konsoliduar me rreth 20 milionë konsumatorë dhe një ekonomi të konsoliduar prej rreth 120 miliardë dollarësh.

Të gjitha bizneset që punojnë në sektorët e shërbimeve dhe që dëshirojnë të ofrojnë shërbimet e tyre në tregje të tjera të CEFTA-s, mund të përfitojnë nga AP6.

Ofrimi i shërbimit mund të bëhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. **Direkt** - kur një furnizues nga një Palë u ofron shërbimin konsumatorëve në një Palë tjetër (p.sh. filma të transmetuar në platformat e internetit, përkthimi i dokumenteve të dërguara në mënyrë elektronike)
2. Kur **një konsumator udhëton** nga njëra Palë në tjetrën për të marrë një shërbim (një turist që përdor shërbimet e hotelit, ose një pacient që merr një shërbim mjekësor)
3. Kur një furnizues shërbimi nga një Palë **regjistron një kompani ose një degë** në një Palë tjetër për të ofruar shërbime në nivel lokal (p.sh. një bankë hap një filial, ose një agjenci komunikimi hap një degë lokale për t'u shërbyer klientëve vendas)
4. Kur një furnizues nga një palë **dërgon përkohësisht njerëzit e tij** për t'i ofruar shërbim një Pale tjetër (p.sh. një kompani ndërtimi që dërgon inxhinierët dhe punëtorët e saj për të ndërtuar një shtëpi, ose një grup muzikor që performon në një festival)

CILAT JANË PËRFITIMET E AP6?

AP6 parashikon një detyrim për Palët për të hequr kufizimet ekzistuese dhe është një garanci që këto kufizime nuk do të aplikohen në të ardhmen.

Kufizimet mund t'i referohen **aksesit në treg** duke limituar:

- Numrin e furnizuesve të shërbimeve
- Vlerën e shërbimit
- Numrin e transaksioneve ose të ndonjë procedure tjetër
- Numrin e personave fizikë që mund të angazhohen në ofrimin e shërbimeve
- Llojin e personit juridik ose së sipërmarrjes së përbashkët
- Pjesëmarrjen e kapitalit në kompanitë vendase

Dhe ato mund të marrin formën e pragut maksimal ose minimal, kuotave, testeve ekonomike etj.

Kufizimet mund t'i referohen **diskriminimit** të kompanive nga rajoni, në krahasim me konkurrentët e tyre vendas, të tilla si taksa dhe tarifa të ndryshme, kërkesa për përvojë të mëparshme në tregun lokal ose vendbanim lokal.



CEFTA

Central European Free Trade Agreement

KA DISA PËRJASHTIME

Aneksi 3 i AP6 rendit të gjitha detyrimet dhe përjashtimet. Ato mund t'i referohen sektorit, mënyrës së ofrimit të shërbimit dhe llojit të kufizimit (qasja në treg dhe trajtimi kombëtar).

RREGULLA TË VEÇANTA PËR PERSONAT FIZIKE

AP6 u mundëson kompanive nga Palët e CEFTA-s, të dërgojnë përkohësisht punonjësit e tyre në tregje të tjera të CEFTA-s. Kjo e drejtë kufizohet në:

- Staf i kryesor në kompani:
 - Vizitorët e biznesit që janë përgjegjës për fillimin e aktivitetit të ri si person juridik, ose zyrës së përfaqësimit (6 muaj qëndrim maksimal)
 - Transferime të menaxherëve dhe specialistëve ndërmjet kompanive (maksimumi pesë vite qëndrimi)
- Personat që do trajnohen (maksimumi një vit)
- Shitësit e shërbimeve të biznesit (maksimumi gjashtë muaj)
- Furnizuesit e shërbimeve (maksimumi gjashtë muaj)
- Profesionistë të pavarur (maksimumi gjashtë muaj)
- Vizitorë afatshkurtër për qëllime biznesi (maksimumi gjashtë muaj)

LIÇENSAT, KUALIFIKIMET PROFESIONALE DHE STANDARDET TEKNIKE

Palët e CEFTA-smund ta kushtëzojnë aksesin në tregun e tyre për furnizuesit e shërbimeve nga tregjet e tjera të CEFTA-s, me marrjen e një liçense, pasjen e kualifikimeve specifike, ose përmbushjen e standardeve të caktuara. Në këtë rast, ata duhet të mundësojnë një procedurë të bazuar në kritere objektive dhe transparente. Nëse rezultati i një procedure të tillë është negativ, furnitorëve duhet t'u jepet akses në procedurën objektive dhe të paanshme të ankimimit. Palët janë angazhuar që së shpejti të bien dakord për rregullat për njohjen e kualifikimeve në profesionet e rregulluara.

TRETI ELEKTRONIKE

Dispozitat e tregtisë elektronike në Protokoll, garantojnë që produktet dixhitale (p.sh., librat elektronikë, file-t muzikorë) të porositura në internet, nuk do t'i nënshtrohen detyrimeve doganore. Dialogu rregullator për tregtinë elektronike ka nisur në dhjetor 2020, duke sjellur si rezultat Plan Veprimin e CEFTA-s për tregtinë elektronike, i cili planifikon aktivitetet që fokusohen në 5 pesë prioritete:

- 1) Harmonizimi i rregulloreve, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe gjeo-blokimin
- 2) Reduktimi i kostove të transaksionit (dorëzimi dhe pagesa)
- 3) Procedura më të lehta doganore për dërgimin dhe marrjen e pakove
- 4) Njohja e nënshkrimeve elektronike dhe formave të tjera të identifikimit elektronik
- 5) Ngritja e kapaciteteve të biznesit

MË SHUMË INFORMACION

Më shumë informacion mund të gjeni në www.cefta.int

Protokolli Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve. Më shumë informacion [këtu](#).

Plani i Veprimit për dialogun rregullator mbi tregtinë elektronike. Më shumë informacion [këtu](#).

Sekretariati i CEFTA-s: **Rue de la Loi, 42/10, 1040 Bruksel, Belgjikë**

 +322-229-10-11

 cefta@cefta.int



2021



Co-funded by
the European Union